



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 38  
Prishtinë, më 1 nëntor 2016, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Elmi Reçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha

**Munguan:** Teuta Rugova dhe Puhie Demaku.

**Pjesëmarrës nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës:** Haki Demolli, ministër; Gjeneral lejtënant Rrahman Rama, komandant i FKS-së, Shkëlzen Sylaj, sekretar, kolonel Jeffrey Fischer, atashë i Mbrojtjes i ShBA-së, Lekë Leka, shef kabineti, Jaser Mulla, asistent i komandantit të FSK-së dhe Remzie Zeqiraj, oficer për marrëdhënie me publikun.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Rexhep Selimi, deputet, Lumnije Murati, ZPRK, Qendresa Misini, Mirlinda Kelmendi, praktikante, Endrit Bytyçi, PIPS, Eugen Cakolli, KDI, Gurjeta Zeka, LVV dhe media.

**Mbledhjen e kryesoi:** Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21 tetor 2016;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21 tetor 2016;**

**Blerta Deliu-Kodra**, tha se në procesverbal nuk është përfshirë propozimi i saj që draft-Deklarata për liberalizimin e vizave, së bashku me propozimet e grupeve parlamentare t'i procedohet Kryesisë së Kuvendit për shqyrtim.

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 21 tetor 2016, me vërejtjen e deputetes Blerta Deliu-Kodra.

## **3. Raportim i ministrit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli;**

**Elmi Reçica** njoftoi se Komisioni për Punë të Jashtme në kompetencën dhe mandatin e tij, përveç politikës së jashtme dhe diplomacisë parlamentare e ka edhe aspektin e sigurisë. Më tej shtoi se segmenti i rëndësishëm është siguria dhe se Kosova e ka një Forcë të Sigurisë, e cila i ka plotësuar kriteret që të shndërrohet në Ushtri të Kosovës. Reçica e njoftoi ministrin se Komisioni është duke mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit dhe në kuadër të kësaj do ta vizitojë Ministrinë për tu njoftuar rreth zbatimit të ligjit në fjalë.

Gjatë Asamblesë Parlamentare të NATO-së, tha se u sqaruan nga ministri shumë gjëra para deputetëve të 23 shteteve dhe në kuadër të atyre zhvillimeve vërehej që FSK-ja e ka një respekt të veçantë.

Ajo çka na mbetet neve është aspekti i ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese për të mundësuar transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, tha z. Reçica.

**Haki Demolli** njoftoi se sa i përket planit të punës së MFSK-së, lidhur me transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës, janë marrë parasysh disa segmente. Segmenti i parë, tha se është Pakoja e Ahtisarit dhe rekomandimi nga rishikimi i strategjisë së sektorit të sigurisë, sipas të cilit rekomandohet që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në Forcë të Armatosur të Kosovës. Lidhur me këtë proces ministri njoftoi se MFSK-ja ka hartuar amendamentet kushtetuese, të cilat kanë marrë pëlqimin nga Gjykata Kushtetuese, dhe se kanë hartuar draft-Ligjin për transformimin e FSK-së në FAK, i cili për shkak të zhvillimeve politike nuk është përcjell për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës. Mosgatishmëria e deputetëve të komuniteti serb për t'i votuar këto dy dokumente, tha se ka qenë shkak për mospërcjelljen e tyre në Kuvend.

Pavarësisht ngecjeve në rrafshin politik, ministri njoftoi se Ministria është duke punuar në planifikimin dhe përgatitjen për transformimin e FSK-së, ka themeluar Departamentin për transformim dhe standardizim, i cili është kompetent për zhvillimin konkret të procesit të transformimit.

Ministri Demolli tha se shtylla kryesore e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur është kohëzgjatja e transformimit, që pritet të jetë një periudhë 10 vjeçare nga momenti i miratimit të amendamenteve dhe i Ligjit për transformimin e FSK-së. Po ashtu, ai njoftoi se numri i pjesëtarëve aktivë të FSK-së nga 2500 do të rritet në 5000, kurse komponenti rezervë nga 800 do të rritet në 3000. Sa i përket buxhetit njoftoi se kanë analizuar dhe planifikuar buxhetin për 10 vitet e ardhshme dhe Qeveria e Kosovës ka garantuar se do ta përkrah financiarisht tërë procesin e transformimit.

Lidhur me bashkëpunimin me institucionet euro-atlantike në procesin e themelimit të Forcës së Armatosur të Kosovës, ministri Demolli njoftoi se tërë procesi është zhvilluar në bashkëveprim me faktorin ndërkombëtar dhe se çdo gjë ndërmerret konform standardeve dhe kriterëve të NATO-së. MFSK-ja dhe FSK-ja mbështetën nga ekipi i NAT-it, i cili është i përbërë nga ushtarakët dhe civilët e shteteve anëtare të NATO-së dhe të partnerëve të NATO-së.

Ministri njoftoi se është takuar me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-së, z. Stoltenberg, për vizitat e zyrtarëve të lartë të NATO-së në MFSK, për vizitat në selinë e NATO-së, dhe për shkresën e

Kryeministrit të Kosovës dërguar NATO-së, për avancimin e nivelit të bashkëpunimit nga ai teknik në atë politik. Pjesëtarët e FSK-së gjatë vitit 2016 kanë marrë pjesë në 16 kurse të organizuara nga NATO-ja, kurse për vitin 2017 janë paraparë 17 kurse. Po ashtu, ai njoftoi për kundërshtimin e Spanjës që një njësit i FSK-së të merr pjesë në një ushtrim të organizuar nga NATO-ja në Poloni, edhe përkundër të gjitha planifikimeve dhe përgatitjeve për të marrë pjesë.

Për përgatitjet e MFSK-së dhe FSK-së, bëri të ditur se është promovuar Qendra Trajnuese për Kërkim dhe Shpëtim. Qëllimi i kësaj qendre është që shtetet në rajon t'i dërgojnë zyrtarët e tyre për trajnim në kërkim-shpëtim. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar bëhet përmes partneritetit bilateral, MFSK-ja ka nënshkruar 12 marrëveshje të bashkëpunimit me 12 shtete, 10 prej tyre janë anëtare të NATO-së dhe se kanë dërguar kërkesa për memorandume bashkëpunimi me Italinë, Republikën Çeke, Zvicrën, Kanadanë, Austrinë dhe Francën.

Ministri tha se, MFSK-ja dhe FSK-ja në rrafshin e bashkëpunimit ndërkombëtar partner strategjik i kanë SHBA-të, konkretisht Gardën Nacionale të Iowa-së, me të cilët në vitin 2016 janë zhvilluar 66 aktivitete të përbashkëta. Po ashtu, ministri Haki Demolli njoftoi se kanë bashkëpunim me Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar të SHBA-ve, e cila e përkrah MFSK-në dhe FSK-në në aspektin arsimit, trajnimit, përkrahjes financiare dhe konsulencës.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, ministri njoftoi se Kosova është anëtare në Këshillin për Bashkëpunimin Rajonal, si dhe në Qendrën Rajonale të Asistencës për Verifikimin dhe Implementimin e Kontrollit të Armëve (RACVIAC), si dhe anëtare vëzhguese e Kartës së Adriatikut A5. Sa i përket A5 ai tha se me përkrahjen e SHBA-së, Kroacisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë synojnë që këtë vit Kosova të jetë anëtare me drejta të plota.

Demolli tha se në SHBA, Gjermani, Suedi, Turqi, Belgjikë dhe Shqipëri, Kosova ka atashe ushtarake, dhe po synojnë që të dërgojnë përfaqësues ushtarake edhe në Britani të Madhe, Francë, Itali dhe Kroaci. Gjatë këtij viti, tha se, për herë të parë, 2 kadetë të FSK-së kanë fituar të drejtën e shkollimit në Akademinë Ushtarake në West Point, që është një prej akademive më prestigjioze.

Ministri njoftoi se Plani i Integritetit është duke u zbatuar në bashkëpunim me Republikën e Norvegjisë, ky projekt zhvillohet me ministrinë e mbrojtjes së shteteve anëtare të NATO-së, ku Kosova është shteti i nëntë.

Sukses të FSK-së, ministri përmendi pjesëmarrjen në ushtrime të ndryshme ushtarake, ku FSK-ja ka marrë pjesë si në Shqipëri, Maqedoni, Slloveni, Kroaci, Gjermani, kurse në Britani të Madhe skuadra e FSK-së është shpërblyer me medaljen e artë. Ministri po ashtu njoftoi se Kadeti Ismail Hoxha është shpallur kadeti më i suksesshëm në Britaninë e Madhe dhe se skuadra e FSK-së ka fituar medaljen e artë nga Brigada e Reagimit të Shpejtë në Britaninë e Madhe, në një garë ku kanë marrë pjesë 118 skuadra nga 16 shtete të ndryshme.

Bashkëpunimi i MFSK-së dhe FSK-së me KFOR-in, tha se është shumë i rëndësishëm dhe përmbajtjesor, këtë vit kanë mbajtur ushtrime të përbashkëta ushtarake dhe do të mbahen edhe gjatë muajit nëntor. Ministri theksoi se me KFOR-in zhvillojnë edhe aktivitete të tjera të karakterit të kërkim-shpëtimit si dhe projekte humanitare. Ministria ka marr vendim që për politikën lidhur me integrimin e komuniteteve në përgjithësi në mënyrë që ata të jenë të pranishëm në FSK me 8.4%.

**Qerim Bajrami** përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi ata për rezultatet e arritura deri tani. Bajrami tha se mbështetë plotësimet dhe ndryshimet kushtetuese dhe Ligjit për formimin e ushtrisë. Ai pyeti se a është paraparë me ndonjë dokument të përmirësohet integrimi i komuniteteve pakicë në FSK, çka konkretisht planifikohet, a do të rritet numri i tyre dhe a do të përmirësohet struktura e kuadrove e përfaqësuesve të komunitetit më të madh në FSK.

**Ismet Beqiri** tha se informatat e ofruara nga ministri, shprehin një punë të madhe që po bëhet në sektorin e sigurisë. Beqiri shtoi se sektori i sigurisë në Kosovë është një sektor i ndjeshëm dhe më specifik sesa në

vendet tjera dhe dihet se çfarë është bërë deri këtu, dhe çfarë pretendohet të bëhet në të ardhmen. Ky shprehur bindjen se do të gjendet forma ligjore për transformimin e FSK-së, sepse është interes i të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Beqiri kërkoi nga ministri që aktivitetet e përmendura t'i dorëzohen Komisionit në formë të shkruar. Sa i përket buxhetit të ministrisë, Beqiri tha se duhet të shihen mundësitë buxhetore sepse ushtria nuk guxon të ngecë për shkak të buxhetit dhe shprehur nevojën se Kosova duhet ta ketë ushtrinë e saj, me gjithë parametrat dhe komponentët e nevojshme, ndërsa falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme që SHBA-ja po e bën për Kosovën, sidomos mbështetjen ndaj FKS-së.

**Blerta Deliu-Kodra** njoftoi se në seminarin e Asamblesë Parlamentare të NATO-së, u potencua qartë perspektiva e Forcave të Armatosura të Kosovës, me një opinion pozitiv nga pothuajse të gjitha shtetet, që është një vlerësim i mirë për punën e Ministrisë.

Sa i përket mirënjohjeve që kanë marrë kadetët znj. Deliu-Kodra e veçoi atë në West Point, ku kanë fituar një femër dhe një mashkull në një garë tejet rigorozë.

Znj. Deliu-Kodra pyeti ministrin rreth bashkëpunimit me vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, si Spanja dhe Greqia, dhe çfarë mund të bëjë Komisioni në këtë drejtim; sa i përket atashëve ushtarakë pyeti ministrin se ka mundësi këmbimi në mes të ekspertëve për t'i marr praktikat më të mira ndërkombëtare. Cilat janë prioritetet sa i përket shtimit të atashëve ushtarakë? Cilat janë planet e FSK-së për të marrë pjesë në arsimimin e kuadrove.

Ajo po ashtu përgëzoi SHBA-të për mbështetjen që po ua japin djemve dhe vajzave të reja të Kosovës dhe tha se Komisioni do të ofrojë gjithë perspektiven dhe angazhimin, që në të ardhmen Kosova ta ketë ushtrinë e saj të përgatitur.

**Pal Lekaj** tha se ministria e ka sjell ligjin për transformimin e FSK-së në Kuvend, i cili është kthyer mbrapsht dhe se kjo duhet të shihet si dështim i Kuvendit.

Sa i përket Listës serbe, Lekaj tha se janë të integruar në institucionet e vendit, mirëpo, çdoherë kur është në pyetje diçka për të mirën e Kosovës ata e bojkotojnë ose e hedhin poshtë çdo propozim. Rreth kësaj Lekaj tha se deputetët duhet të komunikojnë me ta dhe t'i bindim që FSK-ja është edhe në të mirën e tyre dhe pyeti ministrin se çka mund të bëjnë deputetët që ta bindin Listën serbe që të votojnë për transformimin.

Lekaj pyeti ministrin rreth komunikimit me atashetë ushtarakë në ambasada; rreth raportimit dhe takimeve me ta dhe për infrastrukturën pyeti se a kanë objekte të mjaftueshme.

Lidhur me buxhetin, Lekaj tha se në vitin 2016 buxheti i Ministrisë ka qenë rreth 49 milionë euro, kurse në vitin 2017 është më i vogël për 1 milion euro. A do të thotë kjo që nuk po mbështetet sa duhet FSK-ja dhe pse po ndodh ky zvogëlim i buxhetit?

Sa i përket afatit 10 vjeçar të transformimit, Lekaj shprehur mendimin se është i gjatë dhe pyeti ministrin se a po bëhet kjo për shkak të buxhetit, apo për shkak të situatave dhe rrethanave në rajon. Po ashtu, ai pyeti ministrin për marrjen graduale të përgjegjësive nga KFOR-i.

**Zafir Berisha** kërkoi sqarime rreth takimit me përfaqësuesit e Listës Serbe, se a ka dal ndonjë kërkesë shtesë, e cila nuk është në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e vendit.

Lidhur me periudhën 10 vjeçare të transformimit, Berisha tha se është një kohë e gjatë e transformimit dhe pyeti ministrin se a është fjala për kohën që jemi tani, apo pas ndryshimeve që pritet të bëhen.

Berisha shprehur mendimin që disa objektiva të FSK-së duhet të kenë prioritet dhe se mbështetjen e deputetëve do ta ketë FSK-ja, sa i përket aspektit të mbështetjes ligjore dhe financiare, edhe për shkak të ndryshimit global në sferën e sigurisë.

Berisha pyeti ministrin se a ka ndonjë mundësi që transformimi nga Forcat e Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, të ndodhë pa ndryshime kushtetuese, dhe të gjendet një formë tjetër që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

**Luljeta Veselaj-Gutaj** pyeti ministrin se sa është pjesëmarrja e femrave në FSK; a ka interesim të femrave që të jenë pjesëtare të FSK-së dhe a do të ketë në të ardhmen ndonjë kuotë për integrimin e femrave në FSK, apo varët vetëm nga interesimi për pjesëmarrje.

**Rexhep Selimi** tha se ministri mori mbështetje nga deputetët dhe këto mbështetje duhet të reflektohen në grupet parlamentare dhe në seanca, kur bëhet fjalë për vendimmarrje të rëndësishme.

Selimi bëri të ditur se Komisioni për Siguri ka marr pjesë si vëzhgues në takimet e Kartës së Adriatikut A5, dhe se në mekanizmin RACVIAC Kosova është anëtare me kompetenca jo të plota dhe pyeti se sa është arritur lidhur me anëtarësimin në këto mekanizma. Kosova ka raporte me anëtarët e këtyre mekanizmave dhe memorandume bashkëpunimi si dhe marrëveshje të veçanta sa i përket SOFA-së, Adriatik 5 dhe RACVIAC.

Selimi pyeti ministrin se a është negociuar që Republika e Kosovës të hap zyrën e saj ndërlidhëse në selinë e NATO-së në Bruksel. Sa i përket atashëve ushtarakë, ai tha se është numër i vogël dhe përbën pengesë për bashkëpunim me shtete e veçanta në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

**Elmi Reçica** tha se duhet të punohet që të rritet numri i atashëve, sepse përfaqësimi përmes tyre është i rëndësishëm, është formë më konkrete e shkëmbimit të përvojave dhe informacioneve.

Sa i përket ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore për transformimin e FSK-së, Reçica tha se do të gjendet një mënyrë që të nxirret Ligji për Ushtrinë e Kosovës, dhe se ekziston unitet i plotë edhe nga komunitetet jo shumicë. Kosova i ka para vetës dy çështje shumë të rëndësishme; e para është çështja e sigurisë, e cila do të realizohet përmes inkuadrimin në NATO dhe e dyta është zhvillimi ekonomik, lëvizja e lirë dhe prosperiteti i vendit që realizohet përmes angazhimit në Bashkimin Evropian.

**Haki Demolli**, ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës, tha se deputetët e komunitetit jo serb kanë treguar gatishmëri që t'i votojnë amendamentet kushtetuese dhe pa asnjë kusht. Sa i përket pyetjes së deputetit Bajrami, lidhur me politikat për integrimin e komuniteteve jo shumicë, Demolli tha se me ekipet këshilluese në NATO-së është analizuar dhe është nënshkruar dokumenti lidhur me politikat për integrimin e tyre, që një numër i caktuar i komuniteteve të jetë i përfshirë në mekanizmat dhe institucionet e FSK-së, kurse sa i përket strukturave kuadrore, tha se FSK-ja është institucion më specifik dhe nuk mund të bëhen lëvizje e kuadrore brenda institucionit sipas përkatësisë etnike për shkak të standardeve dhe kritereve, sipas të cilave bëhet gradimi.

Rreth pyetjes së deputetit Ismet Beqiri, Ministri Haki Demolli tha se ministria është transparente dhe në çdo kohë është e gatshme të pranojë vizita dhe të përpilojë raporte.

Për pyetjen e deputetes Deliu-Kodra, tha se Spanja nuk mund ta ndalojë pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrimet ushtarake, por të gjitha vendimet në NATO merren me konsensus dhe vetëm një votë kundër mund të ndikojë në vendimmarrje.

Sa i përket planeve të FSK-së në raport me arsimimin e kuadrore, ministri njoftoi se arsimimi i kuadrore bëhet në disa nivele: rekrutët e rinj trajnohen në Qendrën për Trajnim RADOKU, kurse në Qendrën për Studime Universitare, bëhet seleksionimi i kandidatëve për kadetë, ku çdo vit pranohen 12 – 16 kadetë, dy vitet e fundit tha se janë pranuar 3 kadetë nga Republika e Shqipërisë, dhe trajnimi i tyre bëhet në Universitetin Amerikan të Kosovës. Pas përfundimit të studimeve në kuadër të QSU-së, ministri Demolli tha se ata sistemohen nëpër njësi ose dërgohen edhe për 1 deri në 1,5 vite në trajnime në SHBA. Segment tjetër i shkollimit tha se është edhe bashkëpunimi bilateral me vendet e rajonit, ku në Maqedoni shkollohen kadetët e komuniteteve joshqiptare.

Lidhur me pyetjen e deputetit Pal Lekaj se kur do të procedohet Ligji në Kuvend, ministri tha se Ligji është proceduar në Qeveri dhe varet nga agjenda e Kryeministrit se kur do të procedohet në Kuvend. Sa i përket raportimit të atasheve, ministri njoftoi se ata raportojnë në baza javore.

Për infrastrukturën, ministri njoftoi se FSK-ja është trashëgimtare e objekteve ushtarake të Armatës Popullore të ish-Jugosllavisë, e cila ka pas një numër të madh të objekteve në Kosovë dhe është vlerësuar se ka kapacitete të mjaftueshme për vendosjen e pjesëtarëve të FSK-së. Lidhur me periudhën 10 vjeçare të transformimit, tha se varët nga zhvillimi ekonomik i vendit.

Lidhur me pyetjet e deputetit Berisha, ministri Demolli tha se Lista serbe ka pasur kërkesa të arsyeshme dhe njoftoi se procesi i transformimit fillon nga momenti i miratimit të amendamenteve kushtetuese. Sa i përket transformimit të FSK-së pa ndryshime kushtetuese, ministri shprehu mendimin se transformimi duhet të bëhet përmes amendamenteve kushtetuese.

Lidhur me pyetjet e Veselaj-Gutaj, ministri njoftoi se pjesëmarrja e femrave në FSK është 8.2%, është planifikuar që kjo përqindje të rritet në 12-14%, kurse në MFSK është 35%, dhe shtoi se ka interesim për pjesëmarrje, por problem përbën periudha e testimi që është një proces i gjatë kohor.

Rreth pyetjeve të deputetit Rexhep Selimi, ministri Haki Demolli bëri të ditur se janë nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi, lidhur me marrëveshjen SOFA-s, atë e kanë nënshkruar me SHBA-në dhe Shqipërinë dhe është planifikuar të nënshkruhet edhe me Maqedoninë.

Sa i përket Kartës së Adriatikut A5, Demolli tha se ka lëvizje pozitive, por Bosnja është duke krijuar pengesa. Kryeministri Mustafa, ka kërkuar nga NATO-ja që Kosova të hap Zyrën e saj ndërlihdhëse, por Spanja është duke kundërshtuar këtë proces. Sa i përket atasheve ushtarakë, ai njoftoi se numri i tyre do të rritet dhe pritet që në Britaninë e Madhe, Francë, Itali dhe Kroaci të kemi atashetë.

**Elmi Reçica** tha se FSK-ja do ta ketë mbështetjen e fuqishme të Komisionit dhe lidhur me atashetë ushtarakë, tha se MPJ-ja është e interesuar që ta mbështet këtë proces.

Reçica bëri të ditur se diplomacia parlamentare, ushtarake dhe ekonomike do të jenë çështjet dhe angazhimet kyçe, jo vetëm të Komisionit, por edhe të Qeverisë.

#### **4. Të ndryshme.**

**Elmi Reçica** njoftoi se MPJ-ja ka dërguar në besim 3 kandidatë për ambasadorë dhe se sipas Ligjit Komisioni duhet të mbajë seancë të mbyllur dëgjimore, për dëgjimin e tyre.

**Blerta Deliu-Kodra** kërkoi që Komisioni ta trajtojë çështjen e arrestimeve që po bëhen nga ana e autoriteteve serbe. Ajo tha se mund të bëhet presion politik dhe publik dhe të shfrytëzohen mekanizmat që të shihet se çfarë mund të bëhet në këtë drejtim. Propozoj që të bëhet një reagim publik për këtë çështje dhe se Komisioni të dal me një qëndrim karshi arrestimeve sistematike që po ndodhin, tha Deliu-Kodra.

**Elmi Reçica** lidhur me këtë, tha se Kosova nuk ka qasje në Interpol dhe nuk mund ta dimë se kush kërkohet dhe shtoi se ne nuk mund t'ia ndalojmë Serbisë që të arrestojë njerëzit tanë, mirëpo, mund të reagojmë dhe mund ta ftojme ministrin e Brendshëm për këtë çështje.

**Zafir Berisha** njoftoi se në Komisionin për Punë të Brendshme, është trajtuar kjo çështje, dhe anëtarësimi i Kosovës në Interpol është një procedurë shumë e koklavitur, pothuajse e barabartë me atë të anëtarësimit në OKB.

**Qerim Bajrami** propozoi që Komisioni të del me një deklaratë për media, ta gjykoj burgosjen e z. Hilmi Kelmendi, të kërkojë nga institucionet e Kosovës që të marrin informata dhe të ndërmarrim të gjitha masat për lirin e tij.

**Pal Lekaj** lidhur me këtë çështje shprehu mendimin se duhet të mbahet një takim me ministrin e Brendshëm dhe atë të Jashtëm. Lekaj tha se duhet të ekzistojë një kriter që të mos vazhdohen bisedimet pa u pastruar listat.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:*

### ***Përfundim***

*Të nxirret një deklaratë, lidhur me kidnapimin e qytetarit të Republikës së Kosovës z. Hilmi Kelmendi, nga autoritetet serbe. Deklarata të hartohet nga deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Zafir Berisha dhe Pal Lekaj.*

**Qerim Bajrami** njoftoi se Komisioni është ftuar nga komuniteti boshnjak për kulturë "Preporod", që të marrë pjesë në tubimin shkencor me titull "Boshnjakët e Kosovës - e tashmja dhe e ardhmja". Tubimi shkencor tha se do të mbahet në Sarajevë më 24 - 27 nëntor 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Elmi Reçica